



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Z. OLGERT RUMNICI

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë i Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 18.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e Olgert Rumnici, i cili ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, bazuar në nenin 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kritereve ndaluese si dhe duke vlerësuar cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Olgert Rumnici, ushtron funksionin e magjistratit që prej datës 08.11.2013, pasi me dekretin nr. 8378, datë 08.11.2013 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Ai ka një eksperiencë profesionale në pune mbi 5 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë i komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat me shkresën nr.692/1 prot datë 21.02.2020 rezulton se kandidimi i prokurorit Olgert Rumnici mund të ndikojë në veprimtarinë normale të Prokurorisë për shkak të ngarkesës që ka kjo prokurori.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Përfundimisht nga kandidimi për komandim të prokurorit Olgert Rumnici, për shkak se komandimi i tij do të ndikonte veprimtarinë normale të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020